ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**214-22-8829-5-1-1**
Nr i brendshëm	**214-22-094-511**

Sa i përket tenderit për: **"Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitise – vazhdimi i punimeve ".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"NIKA Pro-ing"sh.p.k & N.N.P.T Engineering & N.N.P.ART PROJECT
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Bislimi, Ferizaj
(Adresa)

Ferizaj
(Vendi)

71 000
(Kodi postar)

044 121 152
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Shpend Musa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nika.proing@gmail.com
(Adresa elektronike)

16.08.2023
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 26.08.2022
Hapja e ofertave: 15.09.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK: 04.08.2023
Kerkesa per ri-shqyrtim 09.08.2023
Pergjigja e kerkese per ri-shqyrtim 14.08.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

NIKA PRO-ING SH.P.K VIPI FERIZAJ

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me dt.04.08.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e keni rekomanduar për kontratë grupin e GOE "AAG PROJEKT SH.P.K ; AC ing SH.P.K; Euro Eervices shpk ", ndërsa neve na keni eliminuar me arsyetimin se:

Komisioni i rivlerësimit te ofertave pas kontrollimit dhe ekzaminimit te ofertës tuaj , ka konstatuar se AK-MPB me datën 13.04.2023 ka kërkuar te te gjithë OE pjesëmarrëse vazhdimin e validitetit te ofertave dhe sigurimit te tenderit. Afati i kthimit te përgjigjejes ka qene 5 dite nga data e kërkesës.
Andaj, shihet se ne sistemin e Eprokurimi nuk është vazhduar validiteti i ofertës dhe sigurimi i tenderit brenda afatit te kërkuar nga AK-MPB, mbi bazën e kësaj oferta juaj është administrativisht e papërgjegjshëme dhe komisioni nuk është lëshuar ne vlerësim te mëtutjeshëm.

- Ne me daten 09.08.2023 kemi kerkuar interpretim nga KRPP-ja per Validietin dhe me daten 15.08.2023 na eshte kthyer pergjigja, ku edhe kjo e deshmon se ne kemi pasun validitet.

NIKA PRO-ING SH.P.K FERIZAJ

Pretendimi 1. Sa i përket arsyes tuaj të parë për eliminimin tonë, ju sqarojmë se e njëjta është e paqëndrueshme për faktin se ne e kemi vazhduar dy here vazhdimin e validitetit.

Vendimi per zgjatjen e sigurimit te ofertes & validitetit
1 message

Nika Proing <nika.proing@gmail.com> Wed, Jan 4, 2023 at 1:33 PM
To: adem.sopa@rks-gov.net
Cc: agim.islami@rks-gov.net

I nderuar,

Po ju percjellim vazhdimin e sigurimit dhe validitetit per projekin:

Vazhdimi i puneve- Ndertimi i shkolles fillore ne Pozheran

"Nika Proing" Sh.p.k
04/249-864
nika.proing@gmail.com

2 attachments

1. Vazhdimi i sigurimit te tenderit.pdf 468K

2. Vazhdimi i validitetit.pdf 33K

Gjithashtu përsëri ne e kemi bërë vazhdimin edhe për herën e dytë edhe këtë përmes zyrtarit të prokurimit i cili figuron në dosjen e tenderit, e i cili eshte pergjegjes per këtë aktivitet te prokurimit, ju lutem analizojeni dëshminë e mëposhtme:

Pershendetje
1 message

Nika Proing <nika.proing@gmail.com> Fri, Apr 14, 2023 at 2:16 PM
To: adem.sopa@rks-gov.net

I nderuar, Po ju percjellim vazhdimin e sigurimit dhe validitetit per projekin:,**Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitise – vazhdimi i punimeve**

"Nika Proing" Sh.p.k
04/249-864
nika.proing@gmail.com

2 attachments

Vazhdimii i validitetit.pdf 33K

vazhdimi i sigurimit.pdf 451K

Pasi që lënda ka qenë proces në OSHP, ne në momentin kur e kemi vërejtur që e njëjta është kthyer në ri-vlerësim dhe pas analizës së vendimit kemi vërejtur se lënda është kthyer në rivlerësim, pra është kthyer në piken 0 këtë lëndë atëherë ne e kemi ngritur para procesit të ri-

NIKA PRO-ING SH.P. NPI FERIZAJ

vlerësimit edhe në e-prokurim vazhdimin e validitetit me dëshmi dhe argumente, siç mund ta vërtetoni edhe nga fotografitë e mëposhtme.

Me dt. 31.07.2023 ne kemi ngritur në e prokurim dëshmitë dhe e kemi argumentuar me fakte që oferta jonë ka validitet.





Në kërkesën për qasje ku ne i jemi drejtuar zyrtarit të prokurimit z. Agim Islami, i njëjti na kthen e-mailin dhe citon se të gjitha komunikimet duhet të bëhen përmes e-prokurimit, mirëpo i njëjti **NUK** vepron njëjtë edhe në rastin kur e kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit me dt.04.01.2023, pra në këtë rast po përdoren standarde të dyfishta në lidhje me komunikimet përmes emailit.

Nika Proing <nika.proing@gmail.com> Mon, Aug 7, 2023 at 10:12 AM
To: agim.islami@rks-gov.net

I nderuar,

Kerkojm te na lejoni qasje ne tenderin:
Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitise – vazhdimi i punimeve
214-22-8829-5-1-1

te Dokumentacioni i kompanise fituese dhe korrespodencat mes AK-se dhe ketij GOP ne koncersium, te shpallun fitues me dt. 04.08.2023

Shpend Musa,

"Nika Proing" Sh.p.k
04/249-864
nika.proing@gmail.com

Agim Islami <Agim.Islami@rks-gov.net> Mon, Aug 7, 2023 at 10:27 AM
To: Nika Proing <nika.proing@gmail.com>

Te nderuar

Ju informojme se te gjitha komunikimet lidhur me procedurat e prokurimit , përfshirë edhe kërkesën për qasje duhet behën ne sistemin e e-prokurimit.

Ju lutem qe te ngarkoni kërkesën për qasje ne sistem, ne mënyrë qe te ju japim qasje e kërkuar.

Me respekt

Agim Islami

Pra ne e kemi bërë dy herë vazhdimin e validitetit të ofertës përmes emailit dhe në asnjërën herë nuk na është tërhequr vërejtja që vazhdimi nuk mund të bëhet përmes emailit, mirëpo përkundrazi na është pranuar vazhdimi i validitetit, ndërsa tani po eliminohemi me një arsyetim se kinse nuk lejohet të bëhet vazhdimi i validitetit përmes emailit.

NIKA PRO-ING SH.P.K FERIZAJ

Kemi bere vazhdimin e validitet edhe per heren e tret dhe sigurimin e tenderit ku te cilet i kemi ngarkuar ne sistem.

Ky veprim i AK-së është tendencioz kundrejt kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm, andaj duke u bazuar në sqarimet e lartcekura kuptohet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e paqëndrueshme.

Pretendimi 2. Duke u bazuar në vendimin e OSHP-së me nr.2023/ 0074 ne e kemi vërejtur se GOE "AAG PROJEKT SH.P.K ; AC ing SH.P.K; Euro Eervices Sh.P.K. ", nuk i ploteson kerkesat e dosjes së Tenderit.

Me gjithë këtë sa i përket kërkesave të dosjes rreth makinerisë, konkretisht grederit ku maksimumi i lejuar në dosje ka qenë 5.2 deri 8 ton, OE ka ofruar dëshmi për greder 10 ton, do thotë 2 ton më shumë se pesha maksimale e caktuar nga AK.

Pra nga fakti i lartcekur kuptohet qartë se i njëjti është i **papërgjegjshëm** dhe i njëjti nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.
Në vendimin e OSHP-së ceket:

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, konstaton se AK duhet të jetë më i qartë gjatë vendosjes së specifikimeve teknike e në rastin konkret të sqaroj lidhur me kërkesën e vendosur sa i përket certifikatave CCTV dhe BMS , ofertat e ofruara nga OE ofertues a i plotësojnë kërkesat në mënyrë decidive apo janë ekuivalente për të cilat në kërkesën e vendosur në DT nuk është e lejuar ekuivalenca.

-OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar *"Operatori ekonomik duhet te ofroje si deshmi se posedon keto pajisje*

Eskvator	*3.5-4.5*	*ton*
Cilinder	*3-5*	*ton*
Greder	*5.2-8*	*ton*

Damper 2-5 ton", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Listen e pajisjeve origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Kopjen e librezave ose DUD doganor qe i ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytezimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me deshmit e pronesis. Të gjitha makinerit të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit".*
OE ka ofruar: Grejderin 5.**2-8 ton** ka prezantuar një dud doganor, i cili kur analizohet shihet qartë se grejderi i prezantuar nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit pasi që është me peshë **10 ton**, dhe ne vendimin e OSHP-së ceket që në DT

NIKA PRO-ING SH.P.K FERIZAJ

Pretendimi 3. Ne vendimin e dt. Me nr 2023/0074 se gjitha ofertat duhet te hyn ne ri-vlerësim pasi që edhe paneli shqyrtues ka konstatuar po-ashtu duke u bazuar në interesin e përgjithshëm (konform nenit 104) ka konsideruar se rrethanat kyçe përgjatë shqyrtimit të kësaj ankese kanë qenë çështjet që më parë janë gjykuar me vendimin paraprak të OSHP-së, në të cilin kanë qenë të përfshirë edhe OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet, paneli shqyrtues në rastin konkret duke u bazuar në ekspertizën e fundit vlerëson se tanimë janë paraqitur fakte, rrethana, të gjetura dhe argumentime, pasi për eliminimin tonë me rastin e krijimit të grupit të koncersiumit kemi bërë një gabim teknik ne kemi kërkuar interpretim në KRPP

DATË/A	11.10.2022
REFERENC-Ë	KRPP-DRR-11-10-271/2022
PËR/ZA/TO:	OE " Nika Proing" sh.p.k
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Osman Vishaj, Kryetar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
NGA/OD/FROM :	Arbnora Cakolli-Luzha, Zv. Drejtor i Departamentit të Rregullave Antigona Rexhepi – Sheqiri Zyrtare Ligjore e Departamentit të Rregullave-KRPP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje Kërkesës për Interpretim të datës 06.10.2022

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor si në vijim:

Sa i përket pyetjes së parë KRPP sqaron:

Për të ndihmuar AK-në në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, KRPP ka paraqitë edhe një ***Tabelë*** në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, në të cilën janë paraqitë disa nga **problemet** që mund të hasin AK-të gjatë vlerësimit të tenderëve dhe zgjidhja **si të veprohet.** *Shembujt e paraqitura në këtë tabelë nuk janë te vetmet raste.* ***Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-së.***

Lidhur me sqarimin e tenderëve, paragrafi 1 i nenit 72 të LPP-së përcakton:

*"Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik është ose duket të jetë **jo i plotë** ose **i gabuar**, ose kur **mungojnë dokumentet specifike**, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik qe **të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë** informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".*

NIKA PRO-ING SH.P.K
FERIZAJ

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Në fund kërkojmë nga OSHP:
P.S. Nuk eshte respektuar vendimi i OSHP-se në tërsi

Pretendimi 1. Te na njifet se kemi validitet (deshmit e-mail dhe sigurimet e deklaratat)

Pretendimi 2. GOE "AAG PROJEKT SH.P.K ; AC ing SH.P.K; Euro Eervices Sh.P.K. nuk eshte i pergjegjshem pasi nuk ka ofruar makinerin e ofruar eshte i pa pergjegjshem edhe sipas vendimit te pare te OSHP-se me nr 569/22 dhe 579/22 prap eshte konstatuar me vendimin e dyte te OSHP-se **nr** 2023/0074 **Qe nuk i ka plotesuar kerkesat sipas DT.**

Pretendimi 3. AK-ja te veproj konform LPP-se dhe ligjet ku jane dhene sqarimet / interpretimet nga KRPP, lidhun me validitetin dhe lidhun me krijimin e grupit.

NIKA PRO-ING SH.P.K NPI FIER

8/10

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të OE " **Ndërtimi SHFMU ne Pozharan - Komuna e Vitise – vazhdimi i punimeve** "
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda kthehet në
RI-Vlersim dhe gjatë ri-vlersimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, në vlerë prej 100,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *Kerkesa per KRPP-së*
b) *Pergjigjaj e KRPP-se*
c) *Vendimi i OSHP-se I dhe II*
d) *Deshmite e vazhdimit te validitetit*
e) *Validiteti dhe sigurimet,*

NIKA PRO-ING SH.P.K NPI FERIZAJ